

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6746
E martë, 1 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

**MPB-ja: Pas 21 nëntorit,
gjobë 150 euro
për targat serbe** | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË ME BUJAR BUKOSHIN | FAQE 4-5

KOSOVA ËSHTË I VETMI VEND NË BALLKAN QË NUK KA ASNJË LIDER QË I ËSHTË FSHEHUR DREJTËSISË



Bujar Bukoshi, ish-kryeministër i Kosovës në mërgim, më pas pjesëmarrës aktiv në jetën politike, duke qenë ministër dhe zëvendëskryeministër në Kosovën e pasluftës, prej vitesh është larguar nga skena politike. Bukoshi në një intervistë dhënë gazetës "Tema" ka folur për perspektivën e Kosovës në raport me

zhvillimet ndërkombëtare, përballjen e ish-udhëheqësve politikë të UÇK-së me Gjykatën Speciale dhe rëndësinë e ruajtjes së identitetit shtetëror të Kosovës. Ai ka theksuar se Kosova është i vetmi vend në Ballkan që nuk ka asnjë lider që i është fshehur drejtësisë

AKTUALE



**NORVEGJIA RIT GATISHMËRINË
USHTARAKE NË PËRGJIGJE TË
LUFTËS NË UKRAINË** F. 2

**MSH: 85 MIJË VAKSINA KUNDËR
GRIPIT SEZONAL JANË
NË DISPOZICION TË QYTETARËVE** F. 6



EKONOMI



**ZKA-ja: MMPHI LIDHI 26 KONTRATA
TË NEGOCIUARA NË VLERË
PREJ 5.7 MILIONË EUROSH** F. 8

**GËRXHALIU: ÇFARË BLINIM NË VITIN
2021 ME 100 EURO, SIVJET
S'BLEJMË AS ME 200** F. 8


SPORT



**SONTE PËRBALLEN BAYERN - INTER
DHE LIVERPOOL - NAPOLI** F. 24



**PDK-ja:
QEVERIA KA
NISUR KAPJEN E
ADMINISTRATËS
PUBLIKE, MIJËRA
ZYRTARË
RREZIKOHEN
TË LARGOHEN
NGA PUNA** | FAQE 7



**KURTIT I KËRKOHEJ
T'I NJOFTOJË QYTETARËT PËR
PROPOZIMIN FRANKO-GJERMAN** | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Norvegjia rrit gatishmërinë ushtarake në përgjigje të luftës në Ukrainë

OSLO, 31 TETOR - Norvegjia do ta vendosë ushtrinë e saj në gatishmëri të lartë nga dita e martë, deklaroi kryeministri norvegjez, teksa ky shtet po rrit sigurinë në përgjigje të luftës në Ukrainë.

Norvegjia tani është eksportuesja më e madhe e gazit natyror në Bashkimin Evropian, duke dërguar rreth çerekun e furnizimeve në BE, pasi Rusia ndaloi dërgesat. “Kjo është situata më e rëndë e sigurisë në disa dekada”, tha më 31 tetor kryeministri i Norvegjisë, Jonas Gahr Stoere. “Nuk ka tregues se Rusia po zgjeron luftën e saj në shtetet e tjera, por rritja e tensioneve na bën ne më të ekspozuar ndaj kërcënimeve, operacioneve të inteligjencës dhe fushatave ndikuese”, shtoi ai.

Forcat e armatosura norvegjeze do të kalojnë më shumë kohë në detyra operationale sesa në

stërvitje dhe Garda e Brendshme, që është një forcë e mobilizimit të shpejtë, do të ketë rol më aktiv, tha ministri norvegjez i Mbrojtjes, Bjoern Arild Gram.

Ndërkaq, forcat e armatosura norvegjeze kanë anuluar stërvitjet me Shtetet e Bashkuara me avionët luftarakë F35, duke preferuar që këta avionë të mbesin në Norvegji, tha kreu i forcave të armatosura, gjenerali Eirik Kristoffersen. “Ne presim që kjo situatë të zgjasë të paktën një vit”, tha Kristoffersen.

Norvegjia më herët kishte dislokuar forcat e saj në platformat e gazit që ka në det, pasi u zbuluan rrjedhje në gazsjellësin Rjedha Veriore 1 dhe 2.

Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt dhe së fundmi është përballur me humbje të territorit pas nisjes së një kundëroffensive nga forcat e Kievit.



Irani planifikon gjyq publik për 1 000 protestues në Teheran



TEHERAN, 31 TETOR - Autoritetet iraniane kanë thënë të hënë se do të zhvillojnë gjyq publik për 1 000 njerëz në Teheran pas protestave që janë mbajtur në këtë shtet që disa javë. Paditë masive shënojnë veprimin e parë të madh qeveritar me qëllim të shtypjes së protestave të cilat kanë nisur pas vdekjes së 22-vjeçares Mahsa Amini sa ka qenë në mbajtje. Ajo është ndaluar nga Policia për Moral nën dyshimet se nuk e ka vendosur si duhet mbulesën në kokë.

Agjencia shtetërore e lajmeve IRNA ka cituar zyrtarë të gjyqësorit që kanë thënë se mijëra njerëz që kanë pasur rol

qendror në protesta do të dalin në gjyq në Teheran për shkak të sulmeve ndaj gardës së sigurisë për djegie të pronës publike dhe shkelje të tjera.

Ndonëse protestat fillimisht janë fokusuar në detyrimin për vendosje të mbulesës në kokë, ato shpejt janë kthyer në një prej sfidave më të mëdha për klerikët fetarë prej Revolucionit Islamik të vitit 1979. “Ata që synojnë të përballen me regjimin janë të varur nga të huajt dhe do të ndëshkohen sipas standardeve ligjore”, ka thënë shefi i gjyqësorit, Gholam-Hossein Mohseni Ejei, duke dhënë shenja se disa protestues do të akuzohen për bashkëpunim me qeveritë e

huaja.

Zyrtarët në Teheran kanë pretenduar disa herë, pa ofruar dëshmi, se armiqtë e Iranit janë mbrapa protestave. “Pa asnjë dyshim gjyqtarët tanë do të përballen me këto raste të trazirave, me saktësi dhe shpejtësi”, ka thënë ai.

Sipas grupeve për të drejtat e njeriut, të paktën 270 persona janë vranë dhe mbi 14 000 janë arrestuar që prej shpërthimit të protestave. Autoritetet e drejtësisë kanë ngritur akuza kundër qindra personave edhe në provinca të tjera iraniane. Disa janë akuzuar për “korrupsion në tokë” dhe “luftë kundër Zotit”, akuza që janë të ndëshkueshme me vdekje.

Rekord i ri i inflacionit në Eurozonë

BRUKSEL, 31 TETOR - Inflacioni në Eurozonë ka prekur rekord të ri në tetor, duke arritur në 10.7 për qind në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, ka njoftuar Zyra e Bashkimit Evropian për Statistika, Eurostat. Ekonomistët kanë pritur që shkalla e inflacionit të arrijë në 10.3 për qind.

Inflacioni në tetor është më i larti prej prezantimit të euros më 1999.

Në muajin paraprak çmimet e

konsumit janë rritur për 9.9 për qind.

Ekonomia e Eurozonës është zhvilluar pak më mirë sesa është pritur në muajt e verës, sipas një vlerësimi shtesë të publikuar nga Eurostat.

Në çerekun e tretë, bruto-prodhimi i brendshëm (GDP) në 19 shtetet anëtare është rritur për 0.2 për qind në krahasim me çerekun paraprak.

Rritja e kërkesës për produkte dhe shërbime të tjera, pas

heqjes së masave kufizuese për luftim të pandemisë së koronavirusit dhe lufta e Rusisë në Ukrainë, besohet se janë dy shkaqet kyçe që kanë ndikuar në rritje të inflacionit në shumë vende të botës.

Disa organizata botërore kanë paralajmëruar se bota mund të përballet me recesion global më 2023. Recesioni përshkruhet si turrje e ciklit të bizneset dhe, për pasojë, ka rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik.



Kurtit i kërkohet t'i njoftojë qytetarët për propozimin franko-gjerman

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) dhe Lëvizja për Bashkim (LB) kanë kërkuar nga kryeministri Albin Kurti t'i njoftojë qytetarët për propozimin franko-gjerman. Sipas KMDLNj-së dhe LB-së, deri më tani nuk ka asnjë informatë nga Qeveria e Kosovës as për formën e as për përmbajtjen e këtij propozimi prandaj, sipas tyre, është krijuar hapësirë për manipulim dhe dezinformim rreth marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 TETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar në lidhje me propozimin franko-gjerman për marrëveshjen përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Qe një kohë po qarkullon në opinion një ballon provues në formë të propozimit për një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, i njohur si propozimi franko-gjerman. Këtë propozim emisarët e këtyre dy shteteve ia kanë dorëzuar kryeministrit Kurti në Prishtinë dhe presidentit Vuçiq në Beograd. Në kohën kur Vuçiqi e ka bërë publik këtë propozim, kryeministri Kurti e ka mohuar, kurse presidentja Osmani fillimisht e mohoi për të pranuar, pastaj se ka një propozim të tillë. Deri më tani nuk ka asnjë informatë nga Qeveria e Kosovës, as për formën e as për përmbajtjen e këtij propozimi, prandaj është krijuar hapësirë për manipulim dhe dezinformim duke e bërë edhe më të mjegulluar këtë", ka theksuar KMDLNj, duke shtuar më tej se Qeveria e Kosovës ka demonstruar papërgjegjësi të skajshme duke mos u treguar aspak transparente, as për bisedime e as për marrëveshjen e propozuar, kurse opozita është treguar e pavullnetshme dhe e pavendosur që me metoda parlamentare ta detyrojë kryeministrin Kurti t'i informojë qytetarët për

bisedimet me Serbinë dhe marrëveshjen e propozuar. "Në këtë rast, në mungesë të gatishmërisë së Qeverisë së Kosovës që të jetë transparente, opozita duhet të bëhet zëri i qytetarëve e që nuk është. Opozita ka sjellje oportuniste e që është e palejueshme në kohën kur Kosova po kalon përmes proceseve vendimtare e që pastaj nuk do të mund të riparohen. Në kohën kur qeveria po vdesë nga frika e vendimmarrjes dhe kur opozita po e luan për mrekulli rolin e strucit, qytetarët po informohen nga burime të pasigurta dhe, në emër të Kosovës, po flasin politikanë dhe analistë ndërkombëtarë me afat të skaduar, të cilët duan të faktorizohen përmes riinkarnimit politikë në dëm të Kosovës", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Ky institucion ka shtuar se si mund të jetë një propozim i mirë për Kosovën e për të cilin qytetarët e Kosovës nuk kanë as njohuri elementare për shkak të territ informativ të Qeverisë së Kosovës. "Nuk mund ta përfaqësojë interesin e Kosovës Viola von Kramon që, me metoda gebelsiane, përpiqet të na bindë ta pranojmë një marrëveshje si të mirë pa pasur fare qasje në atë dokument dhe, në të njëjtën kohë, të kërcënojë se propozimi i radhës do të jetë më i keq, përveç si shantazh i ndyrë", thuhet në reagim.

KMDLNj mendon se për çështje madhore për vendin



nuk mund të merren vendime pa opozitën dhe pa qytetarë. "Nëse përmbajtja e tekstit të marrëveshjes për normalizim është ai që po qarkullon në disa media, nuk do të ketë njohje reciproke, nuk do të ketë ulëse në OKB për Kosovën dhe se Asociacioni nuk do të jetë pjesë e pakos së marrëveshjes dhe është pikëpyetje pranimi nga pesë shtetet mosnjohëse. Për këtë arsye Qeveria e Kosovës duhet t'i drejtohet opinionit me informata të sakta, duke mos e mjegulluar edhe më shumë këtë gjendje. E drejta për informim është e drejtë elementare e njeriut dhe, si e tillë është e patjetërsueshme dhe qytetarët nuk duhet të privohen nga kjo e drejtë, sikur deri më tani", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Po ashtu edhe Lëvizja për Bashkim ka theksuar se tanimë është e njohur publikisht edhe ekzistenca e një plani franko-

gjerman për t'u dhënë fund bisedimeve Kosovë - Serbi, me synimin që të përmbillet me një marrëveshje përfundimtare në mes të këtyre dy vendeve. "Madje u tha edhe publikisht se ka një marrëveshje në mes të palëve që ky plan të mos bëhet publik. Edhe pse Qeveria e Kosovës fillimisht e mohoi ekzistencën e këtij plani, tani e thotë hapur se ai plan ekziston, por nuk e ka thënë as edhe një fjalë të vetme për përmbajtjen e tij. Lëvizja Vetëvendosje dhe kryeministri Kurti sa ishin në opozitë i kanë kritikuar zëshëm rivalët e tyre pikërisht për mungesë të transparencës në dialog, por tani e injorojnë plotësisht opinionin publik, madje edhe duke pohuar 'pa frikë' se plani ekziston, por se nuk do ta bëjnë publik. Ky injorim, këto bisedime të fshehta, kjo mungesë e 'frikës' nga opinionin publik, të gjitha këto e bëjnë të frikshme mungesën e transparencës në

dialog", thuhet në komunikatën e LB-së. LB-ja konsideron se kryeministri Kurti duhet ta njoftojë opinionin publik për kornizën e ofruar të marrëveshjes. "Ai dhe Qeveria e Kosovës duhet ta shfrytëzojnë këtë moment që, duke e vendosur në qendër parimin e reciprocitetit, të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme edhe për Kosovën Lindore dhe për veriun e Kosovës. Përndryshe, me këtë qasje të qeverisë, ku njëherë e trajtonte dialogun si prioritet të shtatë a të tetë, e tani e ka prioritet të parë, por duke e mbajtur në fshehtësi procesin, mund të jemi dëshmitarë të marrëveshjeve të cilat nuk i zgjidhin problemet themelore në mes të dy vendeve, duke i shtyrë ato dhe, si pasojë, duke vazhduar ta mbajnë Kosovën në një gjendje të pafavorshme status quo-je", është theksuar në komunikatën e LB-së.

Përrurohet objekti i ri i shkollës "Drita" në Gramaçel të Deçanit

DEÇAN, 31 TETOR - Të hënën në Gramaçel të Deçanit është bërë përrurimi i objektit të shkollës fillore "Drita". Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se ndërtimi i objekteve të reja të shkollës, krijimi i mundësive më të mira për zhvillimin e mësimi si dhe zgjerimi i infrastrukturës shkollore

është një dëshmi se çdo ditë e më shumë arsimit po bëhet prioritet në Kosovë. "Me investimet e bëra, objekti i ri ofron kushte shumë të mira për mësim, një ambient të ngrohtë dhe të përshtatshëm për nxënësit dhe komunitetin. Një falënderim të veçantë për Ministrinë e Arsimit për mbështetjen e dhënë për ndërtimin

e kësaj shkolle dhe zëvendësministren e Arsimit, Edona Maloku-Berdyna, për praninë. Falënderues për punën e palodhshme drejtorit Mujë Avdiu dhe për angazhimin dhe përkushtimin mësimdhënësve të kësaj shkolle. Nxënëseve u urojmë suksese të vazhdueshme dhe të na bëjnë krenarë me arritjet e tyre", ka thënë Ramosaj.





INTERVISTË ME BUJAR BUKOSHIN

Kosova është i vetmi vend në Ballkan që nuk ka asnjë lider që i është fshehur drejtësisë

Bujar Bukoshi, ish-kryeministër i Kosovës në mërgim, më pas pjesëmarrës aktiv në jetën politike, duke qenë ministër dhe zëvendëskryeministër në Kosovën e pasluftës, prej vitesh është larguar nga skena politike. Bukoshi në një intervistë dhënë gazetës "Tema" ka folur për perspektivën e Kosovës në raport me zhvillimet ndërkombëtare, përballjen e ish-udhëheqësve politikë të UÇK-së me Gjykatën Speciale dhe rëndësinë e ruajtjes së identitetit shtetëror të Kosovës. Ai ka theksuar se Kosova është i vetmi vend në Ballkan që nuk ka asnjë lider që i është fshehur drejtësisë

PRISHTINË, 31 TETOR -

Z. Bukoshi, Qeveria e Kosovës po përballet me presionin në rritje të bashkësisë ndërkombëtare për arritjen e një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Hezitimet janë të qarta, po ashtu edhe paralajmërimet e bashkësisë ndërkombëtare. A do të dëshironit të ishit në pozitën e Albin Kurtit në këto çaste?

Bukoshi: Nuk di të them, nëse do të dëshiroja të isha në pozitën e tij, pasi kam kohë që nuk kam më asnjë emocion nga postet politike, por di të them që kur e kemi nisur këtë punë, kemi qenë në anën tjetër të barrikadës. Ishim ne që i luteshim bashkësisë ndërkombëtare të na hapte

dyert, të na priste, të na dëgjonte që t'i shpjegojmë se çka ishte puna e Kosovës dhe çfarë ishte projekti dhe vizioni ynë. Në fund të viteve '80 Kosova ishte një bezdi për diplomacinë ndërkombëtare. Ajo bile përtonte edhe të na dëgjonte. Në vitet '90, kur ne u përpoqëm t'i imponohemi me vetorganizimin tonë politik, kishim përballë një mur indiference, që të trishtonte dhe që u thye falë rezistencës sonë dhe natyrisht për shkak të krimeve të përgjakshme të Serbisë në Ballkan. Edhe sot më ndrydhë ai trishtim për pafuqinë tonë në atë kohë, por më bën edhe krenar që i përballuam ato sfida.

Tani është lehtë të sillesh sikur e kemi ne në dorë fatin e ShBA-së apo Bashkimit Evropian në Ballkan. Por është e rëndë dhe gabim që nuk falet t'ia bësh këtë një vendi, i cili është gjallë falë Perëndimit. Në këtë aspekt, duke thënë këtë, mendoj se kryeministri i Kosovës duhet ta respektojë të shkuarën e Kosovës, historinë e shtetformimit të saj dhe jo të sillt sikur Kosova është shtet i themeluar as dy vjet të plota më parë kur ka ardhur ai në pushtet. Historia nuk fillon nga e para sa herë dikush bëhet kryeministër në këtë vend. E di se fenomene të ngjashme ka pasur edhe përpara, por të pretendosh sot se kjo na qenka qeveria më e mirë në Ballkan, është të shohësh ëndrra në diell, ose të bësh Mynhauzenin.

A jeni në dijeni të ofertës së fundit të marrëveshjes nga pala gjermane që mbështetet nga ShBA-në?

Bukoshi: Jo, nuk jam në dijeni, por arrij ta marr me mend se është një nga ato përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të krijuar klimë besimi te firmosja e një marrëveshjeje përfundimtare. Ajo që duhet të bëjë Qeveria e Kosovës është të

zhvishet nga demagogjia populiste dhe të jetë transparente me publikun duke thënë se çfarë ka në favor dhe çfarë nuk ka në favor Kosova në këtë moment, pra siç thuhet "ku është qari dhe ku zarari"... Ata që tani për tani janë në krye të punëve nuk duhet të sillen si njerëz që kanë lindur vetëm të fitojnë. Duhet të sillen si njerëz që po luftojnë dhe kur lufton edhe mund të pësosh diçka. Mund ta humbësh ndonjë betejë, por s'bën ta humbësh luftën.

Shikoni Serbinë nga ana tjetër. Ka sjellje krejt të kundërt. Ulërin dhe klith sikur ta rrahësh qenin, në stilin "ooo, mbaruam", se gjoja po e shkatërrojnë me marrëveshjen e ofruar a, në fakt, nuk i ka aq keq punët nga ajo marrëveshje. Por në finale e menaxhon reagimin dhe i adaptohet marrëveshjes.

Një fshatar i moshuar imi, pa asnjë fakultet, as master të kryer, më thoshte: biri im, mos u beso shkijevem, se shkau edhe kur të fut përfundi dhe të prish dajak, bërtet dhe thërret "më ndihmoni se më mbyti shqiptari". Politikanët tanë dhe pushtetarët sillen sikur kanë lindur të fitojnë jo vetëm mbi Serbinë, por dhe mbi Bashkimin

Evropian e Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Se e zgjata pak përgjigjen time.

Sa ndikon në këtë situatë fakti që Kurti e ka fushën e zbrazët nga kundërshtarët e tij të fortë që janë në Hagë?

Bukoshi: Kurti nuk e ka betejën me shqiptarët. E ka me Serbinë dhe punën herkuliane ta bindë Bashkësinë Ndërkombëtare. Shqiptarët ia kanë dhënë atij një mandat ta përmbyllë këtë punë. Ai nuk mund të abuzojë me faktin që nuk ka kundërshtarë të fortë. Armiku më i madh i tij tani është vet ish-Albin Kurti i para fitores. Ai që nuk njihnte Republikën, pavarësinë dhe marrëveshjet ndërkombëtare të Kosovës. Tani ky Albin Kurti kryeministër duhet "të vrasë" së pari Albin Kurtin opozitar e pastaj të mendojë si t'i mundë kundërshtarët e tjerë. Dhe nuk është aq e lehtë ta vrasësh vetveten. Ajo do njëfarë burrërie.

A besoni se ngritja e Gjykatës Speciale dhe thirrja në Hagë prej dy vjetësh e drejtuesve kryesorë të UÇK-së ka qenë e llogaritur politikisht për të krijuar këtë situatë?

Bukoshi: Nuk ma merr mendja

që drejtësia vjen prej skemave politike. Nuk dua ta mendoj fare këtë. Aq më tepër një drejtësi për të cilën është investuar nga Perëndimi me qindra miliona euro nga taksapaguesit e tij. Por, mendoj se banaliteti i kësaj situatë me liderët shqiptarë të Kosovës që mbahen në Hagë është, ndoshta, edhe më i keq. Ata mbahen brenda në burg prej dy vjetësh, pa u ngritur ende akuza. Mund të ishin të lirë në Kosovë ndërkohë që askush prej liderëve të Kosovës nuk i ka ikur drejtësisë. Kosova është i vetmi vend në Ballkan që nuk ka asnjë lider që i është fshehur drejtësisë ndërkombëtare dhe asaj vendore, siç ka pasur Kroacia, Bosnja dhe sidomos Serbia. Dhe në këtë aspekt ata mund ta prisnin në liri ngritjen e aktakuzës në gjykatë. Arrestimi dy vjet më parë dhe mbajtja në Hagë, ngjan një përzjerje e shëmtuar e burokracisë perëndimore, orekseve politike të atyre që ngritën një gjykatë bazuar në një raport fals dhe idiotik si ai i Dick Marty dhe më tej dhe disa thikave pas shpine (që dikush dikur i përmendi me ëndje) nga politika e Kosovës. Është e qartë se garnitura politike dhe sidomos ajo diplomatike e Kosovës këto kohë u ka folur në vesh atë që kanë dashur ta dëgjojnë drejtuesit Gjykatës speciale duke e paraqitur Hashim Thaçin dhe të tjerët si njerëz të rrezikshëm për të qëndruar të lirë në Kosovë.

Çfarë nuk shkon te Gjykata Speciale në këtë rast?

Bukoshi: Nuk jam kundër Gjykatës Speciale. Në njëfarë mënyre ne e çuam vetë punën te Gjykata Speciale, me mungesën e një drejtësie efektive në Kosovë. Por në këtë rast Gjykata Speciale po sillet sikur forcat speciale që rrëmbejnë katër veta i fusin në burg e pastaj pyesin çka kanë bërë ata. Ka një sjellje irracionale në këtë pikë që, me sa duket, është shkaktuar nga shumë faktorë lokalë dhe ndërkombëtarë. Nuk pajtohem me faktin që ata duhet të mbaheshin në burg ende pa një akuzë të qartë.

A keni dijeni se çfarë akuzash do të ngrihen ndaj tyre?

Bukoshi: Jo, nuk kam kontakte me ta. Nuk është se kam pasur ndonjë miqësi me ta, por fakti që ata i gjykojnë si kupolë politike e UÇK-së, në përpjekje për ta quajtur UÇK-në si grup kriminal (ndërmarrje e përbashkët kriminale), është një qasje e gabuar dhe e rrezikshme që nuk ka lidhje as me të vërtetën as me historinë. UÇK-ja nuk ishte një grup kriminal dhe ata në të vërtetë nuk ishin kontrolluesit apo udhëheqësit e plotpushtetshëm të UÇK-së. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një reaksion i shqiptarëve ndaj tejzgjatjes së zgjidhjes paqësore të krizës për t'i dhënë fund regjimit të Serbisë naziste në Kosovë. UÇK-në nuk e krijoi

as Hashim Thaçi as ata që janë në Hagë. Ata u përpoqën ta organizojnë atë dhe t'i japin një mburojë politike. Por UÇK-ja lindte në mënyrë spontane në çdo fshat të Kosovës që digjej, në çdo shtëpi ku ndodhte një krim dhe në çdo qytet që kishte një përbashkësi me dhunën. Edhe ne si Qeveri e Kosovës u përpoqëm ta kontrollonim UÇK-në dhe ta fusnim nën mburojë tonë politike, pa hile, por nuk ia dolëm dot. Ajo nuk ishte një ide e jona dhe nuk mund të ishte nën kontrollin tonë. Ajo ishte një reaksion popullor. Hashim Thaçi dhe bashkëpunëtorët e tij arritën me më shumë efikasitet të ishin njerëz të popullarizuar të saj, por jo njerëz që mund të kontrollonin gjithçka aty. Ajo ishte, në thelb, një organizatë e decentralizuar që kishte idhujt e vet, por jo komandantin e vetëm të saj.

Ndaj tyre thuhet se ka akuza direkte edhe për eliminime politike. A jeni në dijeni?

Bukoshi: Nuk kam dijeni për akuza konkrete. E vërteta është se ka pasur tensione dhe përplasje deri në vrasje në vitet e para pas çlirimit, por kjo është pasojë e kulturës sonë politike, mangësive në tolerancën e ndërsjellët dhe standardin e një shoqërie e cila ka plot njolla të errëta brenda saj. Për fat, shumë prej atyre ngjarjeve janë hetuar dhe dihen përgjegjësit. Kjo është një çështje që u përket gjykatave të Kosovës në bazë të fakteve që kanë. Ata janë në Hagë më shumë me dëshmi të policëve serbë sesa të shqiptarëve. Fundi i fundit, ju lutem shumë, ku janë ato organe të famshme të trafikuar, me akuzën primordiale me të cilën Kosova burgoset në Hagë? A mund të më përgjigjet dikush mua që jam marrë edhe me transplantime të veshkës në Klinikën Steglitz në Berlin më 1984? Ku janë ata transplantologët e shtëpisë së verdhë, atje ku arusha e çon postën? Shteti shqiptar (me vonesë) po e ngre këtë pyetje dhe mirë po bën.

Duke qenë se përmendet problemet që ju keni pasur me drejtuesit e UÇK-së gjatë luftës dhe kontradiktat me ta, si e mbani mend ju krijimin e UÇK-së dhe përbashkëtimin me të, qoftë dhe nga ana politike.

Bukoshi: Duhet të biem dakord çfarë quhej publikisht UÇK-ja e çfarë ishte UÇK-ja. Politikisht UÇK-ja quhej një grup me rreth 100 veta që drejtohej nga Lëvizja Popullore e Kosovës dhe që u shfaq gjatë varrimit të një mësuesi shqiptar të Kosovës. Ata ishin një bërthamë e vogël politike dhe nuk mund t'i quash ushtri. Mund t'i quash njësit, mund t'i quash celulë apo parti politike, por jo ushtri. UÇK-ja u formua rrugës nga dhuna serbe dhe si reaksion ndaj përpjekjeve për t'i asgjësuar shqiptarët. Ky grup natyrisht përfitoi "licencën" e saj, por kurrë nuk

pati kontroll mbi të. Unë vetë menjëherë shpreha solidaritetin tim me UÇK-në. Unë mendoja se në ato rrethana vetëmbrojtja dhe kryengritja ishin të nevojshme. Unë mendoja se duhej ta vazhdonim luftën tonë politike, por me një krah të armatosur. Pra, do të ishte politikë me plumba.

A keni pasur takime me drejtues të UÇK-në në atë kohë?

Bukoshi: Unë pata një takim me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Tiranë në vitin 1998. Unë u takova me Hashim Thaçin dhe bashkëpunëtorët e tij. Çështja ime kryesore në takim ishte si më poshtë: konflikti ka plasur; unë i respektoj njerëzit që luftojnë në terren; tani duhet të bashkohemi politikisht dhe ushtarakisht. Unë u thashë atyre se tani duhet t'i bashkojmë të gjitha burimet për qëllimin e përbashkët. Kështu që ua ofrova paratë e qeverisë, oficerë profesionistë dhe përkrahje institucionale. Ne duhet të kishim një shtab suprem të përbashkët dhe gjithë fondet që kishim grumbulluar ndër vite të mund t'i vinim në shërbim të tyre për luftën e armatosur. Në atë kohë UÇK-ja kishte komandantë shumë trima të fshatrave që ishin gati ta sakrifikonin jetën e tyre për luftën.

Si u zhvilluan ngjarjet pas dështimit të Marrëveshjes?

Bukoshi: Vendosëm të krijojmë një forcë të sigurisë nën kontrollin e institucioneve të Kosovës, por që morëm vendim të shkriheshim me ta në terren. Pra urdhëruam që forcat tona të hynin në Kosovë me emblema të UÇK-së, duke dëshmuar kështu jo vetëm pajtimin se UÇK-ja ishte një ushtri e popullit e krijuar nga poshtë, por dhe faktin që ajo nuk kontrollohej nga ndonjë autoritet strikt. Unë e dija se oficerët ushtarakë profesionistë ishin të mirëpritur nga komandantët e fshatrave. Ishte Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ai që kishte rezerva.

Unë e urdhërova Ministrinë e Mbrojtjes që ta koordinonte punën me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së që të dërgonte 30-40 oficerë ushtarakë profesionistë që të hynin në Kosovë dhe të bashkoheshin me UÇK-në sa më parë që të ishte e mundur. Oficerët ushtarakë ishin vendosur në dispozicion të komandantëve të fshatrave. Ishte e rëndësishme që oficerët ushtarakë profesionistë të mos shiheshin sikur po ua merrnin detyrat komandantëve të fshatrave, që e kishin filluar luftën e armatosur. Ne caktuam një buxhet në Ministrinë e Mbrojtjes dhe ministri Ahmet Krasniqi i dha fonde Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

Nëse Gjykata Speciale arrin të ngrehë akuzë për Hashim Thaçin dhe drejtuesit e tjerë politikë, si autoritet që janë përgjegjës për krime të UÇK, sa afër realitetit janë?

Bukoshi: Hashim Thaçi mund të ketë qenë njeri me autoritet, apo me popullaritet siç thuhet shqip, por nuk e ka pasur autoritetin dhe fuqinë reale të komandonte çdo gjë që ndodhte brenda asaj që u quajt UÇK. Ajo ishte luftë e shqiptarëve kundër formacioneve të armatosura të Serbisë. Hashim Thaçi dhe unë ishim politikanë që luftonim ta vinim nën kontroll politik këtë luftë, por as ai, as unë, as Ibrahim Rugova e askush tjetër nuk e kishte autoritetin dhe fuqinë e duhur të kontrollonte atë që ndodhte. Është tjetër gjë të jesh i popullarizuar për shkak të angazhimit në krye të një lëvizje politike dhe tjetër gjë të jesh në gjendje ta kesh autoritetin për ta kontrolluar këtë lëvizje. Hashim Thaçi nuk e ka pasur. As ata të tjerët. As unë në krahun institucional nuk e kam pasur.

Kemi parë disa politikanë të nivelit të lartë që vizitojnë Hagën. Gati është kthyer në pelegrinazh. Komenti juaj?

Bukoshi: E di, i kam parë. Është njerëzore që dikujt që i mungon

Hashim Thaçi apo të tjerët të shkojnë ta takojnë, por kur vizitat bëhen si gjest politik, mendoj se nuk u ndihmojnë shumë atyre që janë aty. E kuptoj pse ndodh kjo. Është dhe një lloj reaksioni ndaj qëndrimit shpeshherë të lig që mbajnë fshehtas institucione apo zyrtarë politikë të Kosovës ndaj tyre, duke i paraqitur si njerëz të rrezikshëm në Kosovë. Kjo natyrisht ka politizuar situatën dhe tani jemi para këtij spektakli. Ata kanë nevojë të ndihmohen nga shteti i Kosovës me fakte që përgënjeshtrojnë akuzat dhe nga diplomacia e Kosovës në rrugën e duhur. Nga diplomacia e Shqipërisë, po ashtu.

Së fundmi a keni një koment rreth tensionit të fundit për targat për të cilat qeveria e Kurtit duket e vendosur të mos lëshojë pe, edhe pse Perëndimi po kërkon ta shtyjë atë afat?

Bukoshi: Më patën pyetur disa miq a e refuzon Kurti shtyrjen e afatit për targat? U thashë "edhe e shtyn edhe këndon", sipas një anekdote të njohur në Kosovë. Rugova i ndërjet shpesh më thoshte: lidhu me të fortin dhe dëgjoje se, përndryshe, nuk ta qet...

Nëse këto që po jua them mund t'ju duken pallavra apo folklor, mund t'ju them pikë përnjëmend sa vijon: Ruajtja e identitetit shtetëror të Kosovës ka shumë rëndësi, por ajo nuk është një betejë që fitohet për një ditë. Me rëndësi më të madhe se kaq është ruajtja e aleancës me Perëndimin, me ShBA-në dhe Bashkimin Evropian, të cilat janë garante afatgjatë të identitetit shtetëror të Kosovës. Ajo është beteja e madhe. Këto betejat e vogla mund të të bëjnë popullor te militantët e tu, por nuk lënë gjurmë në historinë e shtetit. Politikanët e mëdhenj janë ata që u bie në hise të bëjnë marrëveshje të vështira. Për të mos bërë marrëveshje është gjeja më e lehtë, por kjo nuk të bën fitues. Kjo në shumë raste ngjan më shumë si dezertim.



MSh: 85 mijë vakcina kundër gripit sezonal janë në dispozicion të qytetarëve

PRISHTINË, 31 TETOR - Të hënën ka nisur vaksinimi kundër gripit sezonal për qytetarët e Kosovës. Lidhur me këtë, Ministria e Shëndetësisë në një përgjigje për "Telegrafi"-n ka njoftuar se numri i vaksinave në tërë territorin e Kosovës është 85 000. Shpërndarja e tyre është bërë në të gjitha qendrat kryesore të mjekësisë familjare. "Ju informojmë se sasia e vaksinave kundër gripit sezonal është 85 000 vakcina dhe shpërndarja e

tyre është bërë në të gjitha QKMF-të në nivel vendi", ka njoftuar MSh.

Në komunën e Prishtinës këtë vit vaksinimi do të bëhet në 13 QME

Drejtori i Shëndetësisë në komunën e Prishtinës, Bujar Gashi, ka thënë se për momentin në stok janë 6 500 vakcina dhe se të planifikuara deri në përmbylljen e procesit janë 11 000 vakcina kundër gripit sezonal. "Këtë vit vaksinimi

kundër gripit sezonal është decentralizuar nga një njësi në 13 QME. Si rezultat i saj sot nuk është vërejtur grumbullim i qytetarëve. Për momentin kemi 6 500 vakcina në stok, ndërsa të planifikuara janë 11 000 vakcina", thuhet në përgjigjen e Gashit.

Ministria e Shëndetësisë u ka bërë thirrje qytetarëve, sidomos personave më të moshuar dhe personave me sëmundje kronike, që të vaksinohen për t'u mbrojtur nga gripit sezonal.



MPB-ja: Pas 21 nëntorit, gjobë 150 euro për targat serbe



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 31 tetor - Ministria e Punëve të Brendshme ka njoftuar se në të gjitha qendrat e regjistrimit të automjeteve do të vazhdojë regjistrimi i mjeteve të pajisura me targa "PR", "KM", "PZ", "GL", "UR", "PE", "DA" apo "ĐA" nga 10 qershori i vitit 1999 deri me datë 21 prill 2022. "Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 28.10.2022 ka marrë Vendimin nr. 05/103, me të cilin ka vendosur që procesi i regjistrimit të këtyre mjeteve në targa RKS të bëhet i shkallëzuar në faza, deri në përmbylljen e këtij procesi legal dhe legjitim me datë 21 prill 2023.

Të nderuar qytetarë, ju do të keni mundësi të përfitonit nga lehtësirat për regjistrim të mjeteve nga targa ilegale në targa RKS deri me datë 31 mars 2023 duke përfshirë: taksat doganore, taksën administrative në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve, tarifën për targa dhe tarifën për pajisje me certifikatë të regjistrimit të Automjetit. Mjetet tuaja motorike mund t'i regjistroni në cilëndo qendër të regjistrimit, pavarësisht prej vendbanimit apo vendqëndrimit që kanë", ka njoftuar MPB-ja.

Me vendimin e ri, nga data 1 nëntor 2022 të gjithë pronarëve të mjeteve që qarkullojnë me targa ilegale do t'u shqiptohet masa e

qortimit, me kërkesën që të drejtohen në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve për t'i regjistruar mjetet e tyre me targa RKS. "Nga data 21 nëntor deri me datë 21 janar për të gjithë pronarët e mjeteve që qarkullojnë në territorin e Republikës së Kosovës me targa ilegale 'PR', 'KM', 'PZ', 'GL', 'UR', 'PE', 'DA' apo 'ĐA' do të shqiptohet gjobë sipas legjislacionit në fuqi në lartësi prej 150 eurosh", ka njoftuar MPB-ja.

Sipas kësaj ministrie, nga data 21 janar 2023 pronarët e mjeteve me targat "PR", "KM", "PZ", "GL", "UR", "PE", "DA" apo "ĐA", për të hyrë dhe qarkulluar në territorin e Republikës së Kosovës, duhet të

pajisen me targa provuese duke e pasur të drejtën e regjistrimit me targa RKS me lehtësirat e parapara. "Nga data 31 mars deri me datë 21 prill 2023 do të mundësohet regjistrimi i mjeteve me 'PR', 'KM', 'PZ', 'GL', 'UR', 'PE', 'DA' apo 'ĐA' në targa RKS, por nuk do të mund t'i shfrytëzojnë lehtësirat e ofruara deri me këtë datë. Pas datës 21 prill 2023 nuk do të lejohet hyrja apo qarkullimi i mjeteve motorike që posedojnë targa 'PR', 'KM', 'PZ', 'GL', 'UR', 'PE', 'DA' apo 'ĐA' brenda territorit të Republikës së Kosovës. Duam t'i

sigurojmë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës se ky proces ka për synim ligjshmërinë në shtetin tonë, rritjen e sigurisë në trafik dhe nuk është i drejtuar ndaj asnjë etnie të caktuar", është thënë në njoftimin e MPB-së.

Kjo ministri që drejtohet nga Xhelal Sveçla ka ftuar qytetarët të cilët posedojnë mjete të pajisura me targa ilegale "PR", "KM", "PZ", "GL", "UR", "PE", "DA" apo "ĐA", që t'i regjistrojnë mjetet e tyre me targa RKS dhe bashkërisht të përfundojnë me sukses këtë proces.

Petkoviqi: Vendimi i Kurtit për targat ka qenë joligjor dhe i dhunshëm

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, ka thënë se vendimi i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për reregjistrimin e makinave me targa serbe në RKS - Republika e Kosovës, ka qenë "joligjor dhe i dhunshëm", dhe se qëllimi i tij kryesor është "shtypja" e ekzistencës së serbëve në Kosovë. "Kurti ka marrë vendim joligjor që serbët, të cilët kanë makina me targat KM (Mitrovicë e Kosovës), duhet të reregjistrohen në RKS, të cilat janë në kundërshtim me të gjitha marrëveshjet që janë nënshkruar deri më tani", ka thënë Petkoviqi për Radiotelevizionin e Serbisë, duke shtuar se Kurti dëshiron t'i frikësojë serbët.

Nis puna në bllokun e ri operativ të Klinikës së Ortopedisë

PRISHTINË, 31 TETOR - Ka nisur puna në bllokun e ri operativ të Klinikës së Ortopedisë, investim ky i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Në hapjen zyrtare të këtyre sallave e pranishme ishte edhe ushtruesja e detyrës e drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Pranvera Zejnullah-Raçi,

bashkë me drejtorin e Klinikës së Ortopedisë, Gani Jashanica dhe stafin e kësaj klinike.

Në bllokun e ri operativ do të jenë katër salla operative, me kushte moderne, që do ta bëjnë më të lehtë punën e stafit mjekësor dhe trajtimin e pacientëve.

Ky investim është bërë në

kuadër të projektit "Mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ekzistues të bllokut operativ të Klinikës së Ortopedisë".

Zbatimi i projektit do të vazhdojë me pjesën tjetër, ku pas rrënimin të sallave të vjetra operative, do të vazhdohet me investimet e parapara.



PDK-ja: Qeveria ka nisur kapjen e administratës publike, mijëra zyrtarë rrezikohen të largohen nga puna

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 31 TETOR - Koordinator i Departamentit për Drejtësi në Kabinetin për Qeverisje të Mirë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), Përparim Gruda, ka thënë të hënën se qeveria aktuale ka nisur përpjekjet që nëpërmjet ligjit ta kapë administratën publike dhe të largojë nga puna mijëra zyrtarë civilë që kanë pozita menaxheriale. Gruda në një konferencë për medie ka ngritur alarmin se ky veprim i qeverisë aktuale është kundërkushtetues dhe cenon procesin e integritetit evropian të Kosovës.

Ai ka thënë se kjo përpjekje e qeverisë është shantazh dhe kërcënim për ta vënë nën kontroll politik gjithë shërbimin civil të Kosovës. "Qeveria aktuale, pasi ka

kapur çdo institucion publik, duke emëruar e punësuar familjarët e tyre dhe zyrtarët partiakë në pozita drejtuese dhe në borde të institucioneve publike, tani ka nisur përpjekjet kundërkushtetuese në administratën publike. Kjo qeveri këto ditë ka prezantuar Projektligjin për Zyrtarët Publikë të Kosovës, i cili paraqet synimin e qartë të partisë në pushtet për ta politizuar administratën publike të shtetit dhe për ta kthyer atë në shërbim të Lëvizjes Vetëvendosje", ka thënë ai.

Gruda ka deklaruar se nëpërmjet Projektligjit për Zyrtarët Publikë të Kosovës qeveria po cenon sigurinë juridike të shërbimit civil. "Qeveria ka paraparë që pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji, t'u ndërpresë kontratat e punës që kanë fituar sipas aktmërimëve të

përhershme, të gjithë zyrtarëve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike, të shpallë konkurse të reja për të gjitha këto pozita, dhe këto pozita të jenë me mandat katërvjeçar. Këtu bëhet fjalë për mijëra zyrtarë që aktualisht mbajnë këto pozita. Me këtë rast, mijëra familje do të mbesin pa të ardhurat e tyre. Pra, për pozitat e të gjithë këtyre zyrtarëve do të shpallen konkurse të reja dhe atyre do t'u pushojë marrëdhënia e punës që kanë tani, për t'u zëvendësuar me militantë partiakë", është shprehur Gruda. Ai ka thënë se në rast të miratimit dhe zbatimit të këtij projektligji, administrata publike do të politizohet, do të hapet mundësia e korrupsionit dhe do të bëhet e cenueshme sa herë ndërrohen qeveritë.

PDK-ja i ka bërë thirrje qeverisë

Kurti që para se ta miratojë këtë projektligj, t'i largojë dispozitat kundërkushtetuese që shkelin detyrimet e Kosovës karshi Bashkimit Evropian të marra përmes MSA-së. "Po ashtu, i bëjmë thirrje Zyrës së BE-së në Kosovë që ta kundërshtojë me gjithë forcën e saj këtë nismë të qeverisë për ta shkatërruar administratën e shtetit. PDK-ja nuk do të lë mjet dhe rrugë demokratike pa përdorur për t'i mbrojtur shërbyesit civilë nga ky arbitraritet brutal dhe se nuk do të lejojë në asnjë mënyrë që rruga evropiane e Kosovës të pengohet nga mungesa e profesionalizimit, qëllimet jo të mira dhe synimet e qarta të kësaj qeverie për ta vënë administratën e shtetit në shërbim të partisë në pushtet", ka thënë Gruda.

Ai ka theksuar se vërejtjet e Zyrës së Bashkimit Evropian për këtë

projektligj, qeveria aktuale nuk i ka marrë parasysh. "Cenimi i pozitive të tilla bie ndesh me zotimet që Kosova ka marrë me Marrëveshjen për Stabilizim Asociim të lidhur me Bashkimin Evropian. Për saktësi, neni 120 i saj përcakton se Kosova merr përsipër "[...] zhvillimin e mëtutjeshëm të një administrate publike profesionale, efikase dhe të përgjegjshme në Kosovë, bazuar në përpjekjet e deritanishme të ndërmarra për reformat në këtë fushë [...]". Vetë BE-ja dhe SIGMA si organ i specializuar në çështjet e administratës publike brenda BE-së kanë vënë në dukje se projektligji në formën si është prezantuar i shërben vetëm politizimit të administratës dhe korrupsionit të saj për shkak të mungesës së integritetit menaxherial me mandat", ka deklaruar Gruda.



Mbi 50 vullnetarë largojnë mbi 200 thasë mbeturina nga Boga e Rugovës



PRISHTINË, 31 TETOR - Një nga shumë deponi ilegale arriti të largohet në aksionin e pastrimit të ndërmarë në fundjavë në Bogë. Energjia dhe puna ekipore e gjithë të pranishmëve bëri që sërish të kuptohen rëndësia dhe nevoja e një mjedisi të pastër. Pos Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti", ekipit nga Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", vullnetarëve e aktivistëve vendas, grupit iu bashkuan edhe aktivistë të huaj dhe djem të vegjël, të cilët me punën e tyre dëshmuuan dashurinë për një mjedis të pastër. Aksioni shërbeu për t'i shfaqur edhe një herë hapat e vegjël të cilët mund ta bëjnë ndryshimin pozitiv në mjedis e që ky ndryshim arrihet duke filluar nga vetëdijësimi individual i qytetarëve. Me mbi 200

thasë mbeturina të larguara në përpjekje të bëjmë thirrje se është detyrë e secilit nga ne që të kujdesemi për pastërtinë dhe jetueshmërinë në mjedisin që na rrethon.

Organizimi i këtij aktiviteti u mbështet nga WWF Adria. "Bëjmë thirrje për të gjithë vizitorët e Rugovës, banorëve dhe bizneseve lokale atje, që të kujdesen për pastërtinë e asaj ane dhe të bashkohen edhe më shumë në aktivitetet e tjera në të ardhmen. Njëkohësisht, kërkojmë nga institucionet që urgjentisht të ndërmarrin veprime për parandalimin e ndotjes dhe shtimin e kapaciteteve të mbeturinave në Rugovë", u tha në njoftimin për medie.

ZKA-ja: MMPHI lidhi 26 kontrata të negociuara në vlerë prej 5.7 milionë eurosh

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 31 TETOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës me temën "Prokurimet e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vitin 2021".

Fokus kryesor i auditimit janë aktivitetet e prokurimit me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, përmes të cilave MMPHI-ja kishte shpenzuar shuma të konsiderueshme të parave. Sipas ZKA-së, MMPHI ka

lidhur 26 kontrata të negociuara me vlerë të përgjithshme prej 5,7 milionë eurosh vetëm në vitin 2021 duke u renditur si një nga ministrat që më së shumti ka përdorur këtë lloj procedure. "Aktivitetet e prokurimit në çdo autoritet kontraktues duhet të zhvillohen në pajtim me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe trajtimit të barabartë, parime të sanksionuara me Ligjin e Prokurimit Publik. Këto parime kanë për qëllim të sigurojnë se prokurimi për mallra, shërbime dhe punë e arrin qëllimin e përcaktuar si dhe ndihmon organizatën për arritjen e objektivave të saj", ka njoftuar ZKA-ja.



Siç bëhet me dije nga ZKA-ja, përmes këtij auditimi në MMPHI synohet të vlerësohet sa ishte i arsyeshëm dhe në përputhje me

kornizën ligjore të prokurimit publik përdorimi i procedurës së negociuar nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit

Hapësinor dhe Infrastrukturës, a është dokumentuar si duhet përdorimi i kësaj procedure dhe a është arritur vlera për para në këto projekte.

Fushëveprimi i këtij auditimi janë kontratat e lidhura përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vlerë afër 4,9 milionë euro (14 kontrata). "Ky auditim synon ta rrisë llogaridhënien, transparencën dhe integritetin e aktiviteteve të prokurimit publik në MMPHI dhe aty ku është e nevojshme të ofrojë rekomandime që fondet e shpenzuara publike arrijnë vlerën për para", ka njoftuar ZKA-ja.

DHTIK i drejtohet Ramës e Kurtit: Hekurudha Durrës - Prishtinë të jetë me dy linja



PRISHTINË, 31 TETOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës (DHTIK) ka përshëndetur vendimin e marrë në takimin ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë përmes të cilit janë koordinuar për ndërtimin e projektit tregtar në Porto-Romano, integrimi me hekurudhën Durrës - Prishtinë dhe Porti i Thatë në Kosovë. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e

Kosovës konsideron se ky vendim do të ndikojë pozitivisht në rritje të stabilitetit, sigurisë si dhe zhvillimit ekonomik në vend duke rritur kështu shpejtësinë e qarkullimit dhe ul kostot e transportit dhe lëvizjes së qytetarëve. Me fillimin e punës së hekurudhës, Kosova do të bëhet qendër e qarkullimit të mallrave dhe qytetarëve në Ballkan.

"Megjithatë konsiderojmë se hekurudha duhet të jetë me dy linja, që njëkohësisht mund të kemi edhe vajtje edhe ardhje, sepse duke qenë dydrejtësh, ofron shumë më shumë mundësi shkëmbimi dhe bashkëpunimi. Dhoma e Tregtisë konsideron se ndërtimi i hekurudhës me një linjë as për së afërmi nuk i plotëson kërkesat e bizneseve e të qytetarëve për ta rritur

shpejtësinë e dërgimit të mallrave dhe qarkullimit të qytetarëve", thuhet në komunikatën e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, e cila ka kërkuar nga të dy kryeministrat që të merret parasysh kërkesa e bizneseve, në mënyrë që të kemi një zgjidhje më të mirë, më afatgjatë dhe efikase. "Duke marrë parasysh që hekurudhat me dy linja në këtë kohë, kur kërkesat janë shumë të

mëdha, kontribuojnë shumë më shumë në rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë së qarkullimit të udhëtarëve dhe të mallrave, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës i përshëndet dhe do të përkrahë gjithmonë këto veprime dhe vendime të cilat rrisin bashkëpunimin kombëtar si dhe ndikojnë pozitivisht në ekonominë e dy shteteve", thuhet në komunikatën për medie.

Gërxhaliu: Çfarë blinim në vitin 2021 me 100 euro, sivjet s'blejmë as me 200

PRISHTINË, 31 TETOR - Çfarë blinim në vitin 2021 me 100 euro, sivjet s'blejmë as me 200 euro. Kështu ka thënë ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu. Buxhetin e miratuar prej 3 miliardë eurosh, Gërxhaliu ka thënë se nuk duhet marrë me "eufori" ngaqë ai është rezultat

i inflacionit. "Në rrethanat ekzistuese në të cilat gjendet Kosova nuk ka arsye për eufori. Një buxhet i tillë edhe është pritur falë inflacionit dhe ngritjes së çmimeve që në momente të caktuara e kanë kaluar edhe shifrën 100 për qind", ka thënë Gërxhaliu në një prononcim për "Ekonomia

Online".

Njohësi i çështjeve ekonomike nuk ka kursyer kritikën as për qeverinë, për të cilën ka thënë se duhet të ketë "më tepër dialog dhe transparencë". Vëmendje më të shtuar Gërxhaliu ka kërkuar ndaj sektorit privat pasi, sipas tij, ai "po anashkalohet" nga shteti.



Formula e pushtetit



Dhuratë nga Zoti, lojë marrëdhëniesh apo faktor biologjik? Çfarë ka ndryshuar në mënyrën e sigurimit të autoritetit, mbajtjes... dhe dorëzimit

Një nënë, një baba, bijtë që duhet të binden... çështje pushteti. Në shkollë para një profesori... çështje pushteti. Shpërndarja e hapësirave në vendin e punës... çështje pushteti. Organizimi i një shteti... çështje pushteti.

Njerëzimi e ka ngritur strukturën e vet sociale mbi pushtetin. Dhe falë krijimit të hierarkive, ka mundur të përparojë. Fjalë të antropologëve, psikologëve, sociologëve.

"Vetë ideja e pushtetit është e natyrishtme, e qenësishme në trurin tonë. Sepse e ka origjinën në marrëdhënien prind-fëmijë. Të gjithë lindin në gjendje varësie, por tek kafshët ky raport pabarazie ka një jetëgjatësi të kufizuar, ndërkohë që tek njeriu, i cili kalon një periudhë të gjatë "stazhi", ndikon gjatë gjithë kohës së rritjes", shpjegon paolo Pombeni, docent i historisë së sistemeve politike europiane në Universitetin e Bolonjës. Është teoria psikanalitike mbi pushtetin: fëmija ndihet i pafuqishëm, dhe kjo i jep një dëshirë të fortë për t'u bërë i pushtetshëm. Dëshiron të konfirmohet, dhe të demonstrojë që edhe ai mund t'u imponojë të tjerëve atë që do. "Nga kjo gjendje e varësisë prej prindërve buron ndoshta edhe ideja që hyjnia, si nënë (apo atë) e njerëzimit, është mbajtëse e pushtetit dhe që si pasojë, mundet që, tamam siç bën një prind me fëmijën kur rritet, t'ia japë njeriut (pushtetin)", vazhdon Pombeni. Psikologët socialë thonë se të gjithë marrëdhëniet njerëzore, si në nivel personal, si në grup apo mes grupeve të ndryshëm rregullohen prej marrëdhëniesh të pushtetit. Po çfarë nënkuptohet me saktësi, kur flitet për pushtet? Definicionet janë të shumtë. Për sociologun dhe profesorin e New York University, Dennis Wrong, "pushteti është aftësia për të prodhuar tek të tjerët

efektet e dëshiruar dhe parashikuar". Sipas Robert Alan Dahl, studiues i shkencave politike, sot profesor emerituar në Yale, "pushteti është aftësia për të bërë dikë të tjerët në një mënyrë që vetë nuk do ta bëjë". Për sociologun amerikan Robert Bierstedt, "pushteti nuk është gjë tjetër veçse aftësia për të përdorur forcën".

Pra, të gjithë definicionet mbërrijnë në të njëjtin konkluzion: pushteti social është aftësia për të vendosur marrëdhënie asimetrike, në të cilat kush komandon është mbi persona apo grupe njerëzish. Dhe shumë studiues bëjnë dallimin mes pushtetit imponues dhe pushtetit me konsensus, mbi ata mbi të cilët ushtrohet. Jo më kot, psikologu gjerman Kurt Lewin (1890-1947) e përcaktoi pushtetin me një formulë. Sipas tij, është i barabartë meraportin e forcës maksimale që A mund të ushtrojë ndaj B, ndaj rezistencës maksimale me të cilën B mund t'i kundërvihet A. Nga Zoti, tek ligji Megjithatë, koncepti i pushtetit social ka ndryshuar shumë gjatë historisë. Për qytetërimet e parë, pushteti ishte me origjinë hyjnore dhe shihej si një dhuratë që perënditë u kishin bërë një apo më shumë të vdeqshmëve (ideja mbeti në modë deri në kohën e revolucionit francez). Por që në shekujt VII-VI p.e.s. në Greqi, pushteti nuk mund të ishte absolut, arbitrar: duhej të ushtrohej brenda kuadrin të ligjeve të kodifikuara. Epikuri mohonte madje origjinën hyjnore të komandës. Por, ardhja e kristianizmit riktheu idenë e një mbretërie të bekuar nga Zoti. Vetëm me Rilindjen dhe shkrimet e Makiavelit, nisi ndarja vendimtare mes politikës, moralit dhe fesë. "Pushteti ka qenë antropocentrik, domethënë në duar të njeriut, deri në shekullin XVII, kur filozofia politike nxorri në pah problemin e kufizimit të arbitraritetit

të tij", sqaron Pombeni. "Dhe më në fund, në vitin 1830 juristët gjermanë dhanë të parët sovranitetin si element të konceptit të shtetit, e si pasojë të popullit. Gjithë kjo për të shmangur që pushteti të identifikohet me një person të vetëm".

Njerëz të fortë

Atëherë, përse aspirantët për diktatorë (edhe kohët e fundit) nuk kanë patur shumë vështirësi në marrjen e pushtetit? Sipas Jean Lipman-Blumen, psikolog i organizatave në Universitetin e Claremont (Kaliforni), në momente krizash njerëzit kanë prirjen që t'i besojnë verbërisht një figure që shfaqet e aftë të zgjidhë probleme që përdryshe duken të pazgjidhshëm. Për Franz Neumann, një prej historianëve që janë marrë gjatë me ngjitjen dhe ruajtjen e pushtetit të diktaturave të fillimit të Nëntëqindës, sado që të gjithë diktatorët janë përpjekur të ngulisin një lloj frike tek të nënshtruarit, ajo që i ka mbajtur nën komandë ka qenë mbi të gjitha shpresa, e përhapur nëpër popull, se këta njerëz të fortë do të mund t'i çlironin nga mjerimi dhe ndjenja e dëshpërimit.

Një mekanizëm i ngjashëm është verifikuar edhe "në laborator": në studimin e burgut të kryer nga BBC, pjesëmarrësit kishin cmontuar sistemin e pushtetit, ku rojat komandonin të burgosurit dhe kishin instaluar një sistem barazist, në të cilin një kolektiv udhëhiqte një komunitet të formuar si nga të burgosurit, ashtu edhe nga ata që i ruanin. E megjithatë, pas pak kohësh, disa anëtarë ripropozuan një sistem të ngurtë hierarkik i cili rikthente pabarazitë. "U kemi kërkuar pjesëmarrësve se përse ndodhi, dhe shumë prej tyre u

përgjigjën se ishte e lodhshme të bëje të funksiononte kolektivin, dhe që loja as nuk ia vlente mundimin", tregon Alex Haslam, studiues i Shkollës së Psikologjisë pranë Universitetit të Queensland (Britani e Madhe), një prej kuratorëve të studimit. Tendenca për t'ia lënë përgjegjësinë dikujt tjetër në situata të pasigurta është një prej mekanizmave që, sot ashtu si dje, mbështesin pushtetin.

Identifikimi tek kreu Por ka një tjetër, edhe më të rëndësishëm: "Sot nuk është e mundur të udhëheqësh një grup personash nëse autoriteti nuk pranohet prej të udhëhequrve, të cilët identifikohen tek kreu i tyre, deri sa ta konsiderojnë "njërin prej tyre", shton Haslam. Në fund të fundit, pushteti mund të mbështetet tek konsensusi popullor edhe në të kaluarën: "Pushteti i marrë tërësisht me forcë nuk ekziston. Dhe nëse ekziston, zgjat shumë pak", thotë Pombeni. "Edhe në regjimet absolutë më të lashtë, një pjesë e madhe e të qeverisurve mendonin që mbretëria kish me të vërtetë të drejtën të komandoje. Nuk ishte ende si të mendosh që "të përfaqësohesh nga kreu", por në atë kohë hendeku social mes të qeverisurës dhe mbretit që ia kish dhënë pushtetin Zoti ishte i pakapërcyeshëm".

Sidomos sot, kur sistemi demokratik është pjesë e mënyrës sonë të të menduarit, për të na çuar të ndjekim dikë, të përqafojmë idetë e tij, në praktikë për të pranuar që një tjetër person të na udhëheqë, shërben mbi të gjitha konstatimi që kryetari është "njëri prej nesh". Kështu funksionon në familje, në punë, në politikë. E provojnë shumë eksperimente, si ai i ideuar nga Michael Hogg, profesor i psikologjisë sociale në Universitetin e Claremont, gjatë të cilit disa studentë duhej të zgjidhnin

se çfarë opinionin të ndiqnin mbi një problem që u përkiste të gjithëve (futja e provimeve të hyrjes në universitet). Rezultati: pavarësisht nga opinionin, studentët ndiqnin idenë që përqafohej nga ata që i pranonin si të ngjashmit e tyre (e njëjta moshë, e njëjta prejardhje). Pra, pushteti për të krijuar ndjekës, ashtu si bukuria, qëndron në sytë e atij që vështron.

Dominimi

Antropologët bien dakord, por vetëm pjesërisht. Për ta, në qendër të pushtetit është mekanizmi i lashtë biologjik: raporti i dominimit mes individëve. I ashtuquajtur "tipi dominues": i gjatë, shpatullgjerë, nofull katrorë. Është ky që zakonisht ka më shumë sukses. Disa prej këtyre tipareve somatike janë të lidhur me sasinë pakëz më të lartë se mesatarja e testosteronit, hormon i pranishëm si tek burrat, edhe tek gratë. Tek të gjithë sisorët, individ dominues ka norma më të larta të këtij hormoni në gjak. Burrat me më shumë testosteron, për shembull, sipas një studimi të para disa viteve, kryer nga psikologu amerikan James Dabbs, hyjnë më me shpejtësi në një dhomë ku e dinë se do të gjejnë persona të panjohur dhe fillojnë të parët të bashkëbisedojnë me ta. Pushteti nuk është vetëm një lojë për të rritur. Studime të kohëve të fundit të kryer tek fëmijët e mitur nga Nathan Fox, një studiues i Universitetit të Maryland, demonstrojnë se, që në moshën 4-muajsh, disa individë zhvillojnë aftësi sociale të habitshme, duke ndërvepruar si me të rriturit, edhe me bashkëmohatarët në mënyrë të sigurtë. Pra, krijojnë idenë që e dinë se çfarë duan dhe si ta arrijnë. Pra, pushteti manifestohet që në djep. / Focus - Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sonte përballen Bayern - Inter dhe Liverpool - Napoli

Sonte Liga e Kampionëve sjell dy ndeshje mes skuadrave gjigante Bayern - Inter dhe Liverpool - Napoli me fillim nga ora 21:00. Të katër këto skuadra kanë siguruar kualifikimin, ndërsa situatë e paqartë është vetëm në Grupin D, ku të katër skuadrat janë në garë për kualifikim

"Epoka e re"

MUNCHEN, 31 TETOR - Bayern Muncheni dhe Interi sonte (e martë) e mbyllin fazën e grupeve në Ligën e Kampionëve me përballjen që zhvillohet në "Allianz Arena" në kuadër të Grupit B. Këto dy skuadra tashmë i kanë siguruar dy pozitizat e para dhe do të luajnë vetëm për prestigj. Bayerni ka fituar pesë ndeshjet e zhvilluara në këtë edicion dhe ka grumbulluar 15 pikë, ndërsa Interi ka grumbulluar 10 pikë për ta siguruar vendin e dytë, ndërsa Barcelona do t'i vazhdojë garat në Ligën e Evropës. Forma e gjermanëve në një grup



Formacionet e mundshme:

Bayern Munchen: Ulreich; Mazraoui, Upamecano, Pavard, Davies; Sabitzer, Goretzka; Coman, Musiala, Mane; Choupo-Moting.
Inter: Onana; Skriniar, De Vrij, Acerbi; Dumfries, Barella, Asllani, Mkhitarjan, Dimarco; Dzeko, L. Martinez.

të vështirë ka qenë tepër mbresëlënëse të cilët kanë fituar të gjitha ndeshjet dhe kanë shënuar 16 gola, kurse kanë pranuar vetëm dy gola. Klubi që drejtohet nga Julian Nagelsmann vitin e kaluar është eliminuar nga Villarreali sezonin e kaluar, por e ngriti trofeun në vitin 2020 duke

mundur Paris Saint-Germain në finale. Bayerni në Bundesliga e mposhti në fundjavë Mainz (6-2) dhe ka pikë pas Union Berlin. Në anën tjetër, Interi e siguroi kualifikimin pas fitores 4-0 ndaj Viktoria Plzenit. Vendimtar për kualifikim ishte barazimi me Barcelonën (3-3). Interi edicionin

e fundit në Ligën e Kampionëve u eliminua nga Liverpooli, kurse herën e fundit që e kishte fituar trofeun më të çmueshëm në futboll ishte në vitin 2010, kur e mposhti në finale Bayernin. Skuadra e Simone Inzaghit në ndeshjen e fundit në kampionat fitoi ndaj Sampdorias me rezultat 3-0. Mungesat e Bayernit për këtë ndeshje janë Bouna Sarr, Lucas Hernandez, Manuel Neuer, Leroy Sane, Thomas Muller dhe Matthijs de Ligt. Në anën tjetër mungesa do të ketë edhe Interi:

Dalbert, Marcelo Brozović, Gabriel Brazao dhe Romelu Lukaku. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi do të përballen Viktoria Plzeni dhe Barcelona, ndeshje e cila nuk ka ndonjë rëndësi të madhe sa iu përket pikëve. Në Grupin A Liverpooli përballlet me Napolin dhe do të përpiqet të shënojë fitore dhe ta rrëmbejë pozitën e parë në grup. Në ndeshjen e parë italianët shënuan fitore me rezultat bindës 4-1. Në ndeshjen tjetër përballen Rangers - Ajax.

GRUPI A		GRUPI C	
21:00 Liverpool - Napoli 21:00 Rangers - Ajax		21:00 Bayern Munchen - Inter 21:00 Viktoria Plzen - Barcelona	
Tabela		Tabela	
1. Napoli	15 pikë	1. Bayern Munchen	15 pikë
2. Liverpooli	12	2. Inter	10
3. Ajaxi	3	3. Barcelona	4
4. Ragners	0	4. Viktoria Plzen	0
GRUPI B		GRUPI D	
18:45 Bayer Leverkusen - Club Brugge 18:45 Porto - Atletico Madrid		21:00 Marseille - Tottenham Hotspur 21:00 Sporting - Eintracht Frankfurt	
Tabela		Tabela	
1. Club Brugge	10 pikë	1. Tottenham Hotspur	8 pikë
2. Porto	9	2. Sporting	7
3. Atletico Madrid	5	3. Frankfurt	7
4. Bayer Leverkusen	4	4. Marseille	6

Superkupa e Kosovës në basketboll shtyhet për dhjetor



PRISHTINË, 31 TETOR - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 31 tetor ka marrë vendim ta shtyjë organizimin e Superkupës së Kosovës në konkurrencën e meshkujve. Superkupa e Kosovës (meshkujt) ishte paraparë të

organizohet prej 9-13 nëntor 2022, data në të cilat organizohet edhe FIBA Window (7-15 nëntor 2022), në të cilat gara do të paraqitet kryetrajneri i KB Golden Eagle Ylli, së bashku me lojtarin e të njëjtit ekip për Kombëtaren e Bosnjë-Hercegovinës.

Bordi i FBK-së ka vendosur që Superkupa e Kosovës të organizohet prej 7 deri më 11 dhjetor 2022. "Konform kalendarëve të FIBA-s, Federata e Basketbollit të Kosovës duhet t'u përshtatet garave të FIBA-s, andaj bordi i FBK-së i ka miratuar

edhe propozim-ndryshimet në kalendarin e garave të Prince Caffè Superligës së Kosovës, për të cilat do të njoftohen të gjitha grupet e interesit. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Juventusit dhe Roma në janar do të bëjnë ofertë për Xhakën



LONDËR, 31 TETOR - Mesfushori i Arsenalit, Granit Xhaka, është duke kaluar nëpër një formë të shkëlqyer. 30-vjeçari shqiptar ka zhvilluar 16 ndeshje me londinezët ku ka shënuar katër gola dhe ka asistuar në tri herë, duke konfirmuar formën e jashtëzakonshme që po

kalon. Ekspertë të futbollit, ish-futbollistë dhe trajnerë në Angli, kanë thënë se Xhaka është më meritori që Arsenalit po kalon nëpër një formë të shkëlqyer këtë edicion. Por "Topçinjtë" duhet të kenë kujdes, pasi dy gjigantët italianë, Roma dhe Juventusit, janë

rikthyer në garë për Xhakën. Ka qenë mediumi italian "SportMediaset" që ka raportuar se Juventusit dhe Roma janë duke përcjellë Xhakën dhe mund të dalin me oferta në drejtim të Arsenalit në janar. Në fakt, dy klubet italiane edhe në verë u

interesuan për Xhakën, por klubi anglez nuk lejoi largimin e tij. Kontrata aktuale e Xhakës me Arsenalin skadon në verën e vitit 2024, ndërsa drejtuesit e klubit synojnë t'ia vazhdojnë atij deri në verën e vitit 2026 ku do të ketë edhe një rritje të ndjeshme të pagës.

Trajneri i Clujit: Ballkani ishte surpriza e këtij grupi

CLUJ-NAPOCA, 31 TETOR - Skuadra e Ballkanit të enjten do të përballlet me CFR Cluj në ndeshjen e fundit të fazës së grupeve të Ligës së Konferencës. Rumunët e konsiderojnë Ballkanin si befasi të këtij grupi, para duelit në "Pro Arena". "Shansi

ynë i vetëm është të fitojmë. Por, Ballkani e ka një skuadër që i ka shënuar 6 gola në udhëtim, me Sivassporin dhe Slavian. Është e qartë se do të jetë shumë e vështirë për ne. Të enjten e kemi mundësinë të shkojmë në pranverën evropiane. Do të

ishte një sukses material dhe futbollistik. Ballkani është surpriza e këtij grupi", ka deklaruar trajneri i Clujit, Dan Petrescu. Mediumi rumun "sport.ru" e përmend edhe faktin se Ballkani i ka shtyrë tri ndeshje kampionale, vetëm

për të qenë i fokusuar në garat evropiane, por që për momentin gjendet në vendin e fundit në grup. Ndeshja e parë mes Ballkanit dhe Clujit, e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, kishte përfunduar baras, 1-1.



Hamiltoni: Strategjia e gabuar e gomave na hoqi fitoren nga duart

LONDËR, 31 TETOR - Në dy garat e fundit, Amerikë dhe Meksikë, piloti britanik Lewis Hamilton, është renditur i dyti, duke iu afruar shumë fitores, por pa mundur ta shijojë atë. Në garën e fundit të zhvilluar në Meksikë, 7 herë kampioni i botës mendoi për një moment

se mund të korrë suksesin e parë sezonal, por nuk ia doli mbanë. Hamilton përdori një strategji ndryshe gomash nga Max Verstappen, por që nuk i dha rezultat në fundin e garës, ku u detyrua të garojë me gomat e forta, ndërsa holandezi me ato të mesme.

“Meksika na dha shumë dashuri. Isha shumë pranë Red Bull, por ato ishin shumë të shpejta. Mund të kishim fituar, por gomat na penalizuan”, ka thënë piloti i Mercedesit. “Red Bull pati një strategji më të mirë gomash. Përdorimi i gomave të mesme në fillimin e

garës nuk ishte zgjedhja e duhur për ne, pasi duhej të ishim nisur me gomat e buta, ashtu si rivalët tanë. Ndërsa me gomat e forta, makina nuk ishte më e balancuar dhe vuajta shumë. Mercedes nuk duhej të bënte këtë gabim”, ka deklaruar Hamilton.



Festim Alidema, ‘Ylli i javës’ në Superligë

PRISHTINË, 31 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, “Albi Mall”, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës” pas çdo xhiroje në Albi Mall Superligë. Çmimi i më të mirit për javën e 14-t i ka takuar futbollistit të KF Llapi, Festim Alidema. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit, në përbërje: Tahir Morina, Ilmi Mehmeti dhe Seladin Jerliu. Festim Alidema u vlerësua më meritori për fitoren që skuadra llapjane e realizoi ndaj lideres së renditjes, Dritës, me rezultat 4-1. Në fakt, Alidema pati paraqitje të shkëlqyeshme në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “Zahir Pajaziti”, duke qenë kreator i lojës së KF Llapi dhe asistues në tre gola për bashkëlojtarët e tij. Çmimin “Ylli i javës” për Alidemën e ndau Valon Topalli, zëvendësmentaxher në “Albi Mall”. Pas marrjes së çmimit, futbollisti i



llapjanëve u shpreh falënderues për vlerësimin, teksa theksoi se skuadra e tij do të vazhdojë të punojë në realizimin e objektivave të këtij edicioni. “Çmimi ‘Ylli i javës’ është një motiv shtesë për mua që tashmë jam duke u rikthyer në formën time të mëparshme. Për këtë çmim

meritorë janë edhe bashkëlojtarët dhe shtabi teknik, të cilëve u jam falënderues. Llapi është duke e gjetur formën nga ndeshja në ndeshje dhe si gjithmonë edhe këtë edicion nuk do të dorëzohemi drejt synimeve tona”, ka thënë Alidema për faqen zyrtare të FFK-së.

Lakersat korrin fitoren e parë, humbja e dytë radhazi për Warriorsin

LOS ANXHELOS, 31 TETOR - Pas pesë humbjesh vjen fitorja e parë në kampionat për Lakersat, që fituan me rezultat 121-110 ndaj Denverit. Rikthimi i Davisit (23 pikë e 15 rebounde) ndikoi në këtë rezultat, ndërkohë që shënuesi më i mirë ishte LeBron Jamesi me 28 pikë. Këtë herë u dallua edhe stoli për lakersat, nga ku erdhën 41 pikë, duke i bërë të pavlefshme 23 pikët e 14 reboundet e Jokiqit. Humbja e dytë brenda 24-orësh për kampionët e Golden States, që u mundën 128-114 nga Detroiti. Curry me 32 pikë e Poole me 30 u përpoqën të mbajnë në lojë Warriorsin por, pa sukses. Për Detroitin të gjithë titullarët realizuan mbi 15 pikë (Bey me 28 më i miri). Pa problem fitoi skuadra e Bostonit, që mundi 112-94 Washingtonin (Browni 24 pikë, Tatum e Brogdoni nga 23 pikë secili), ndërsa San Antonio mposhti 108-97 Minnesotan (Johnsoni 25 pikë), duke qenë skuadra surprizë e këtij sezoni. Në takimet e tjera, Phoenixi mposhti me rezultat 124-109 Houstonin falë 30 pikëve të Bookerit, ndërsa New Orleansi mposhti 112-91 Clippersin (McCollum 22 pikë).



REZULTATET

Clippers - New Orleans	91-112
Boston - Washington	112-94
Cleveland - New York	121-108
Detroit - Golden State	128-114
San Antonio - Minnesota	107-98
Dallas - Orlando	114-105
Phoenix - Houston	124-109
Lakers - Denver	121-110

SHKURT

Visar Kastrati ndan drejtësinë në Ligën e Kampionëve U19

Në mesjavë zhvillohet takimi ndërmjet skuadrës çeke FC Viktoria Plzen dhe asaj spanjolle FC Barcelona në kuadër të Grupit C të Ligës së Kampionëve për të Rinj U19. Kjo ndeshje i është besuar gjyqtarit nga Kosova, Visar Kastrati. Kastrati do të ndihmohet nga Granit Hyseni dhe Lumturije Muhadri. Kjo ndeshje zhvillohet ditën e martë në orën 12:00 në “Stadion TJ Přeštice” në Çeki.

Kahn: Neueri vendos vetë për Botëror

Kapiteni i Bayern Munchenit dhe Gjermanisë, Manuel Neuer, është kthyer në dilemën më të madhe jo vetëm në “Allianz Arena”, por edhe në kombëtaren e “pancerave”. Fillimi i kompeticionit më të rëndësishëm në rang përfaqësues dhe prania e kapitenit Neuer shikohet në rrezik pas rilëndimit të fundit në seancat individuale. Kahn ka dashur t'i zbusë qëndrimet dhe ta zhvendosë fokusin diku tjetër, por pa e anashkaluar si diskutim, duke pohuar: “Optimizmi nuk mungon rreth gjendjes së Manuelit pavarësisht se ai vazhdon të vuajë ende nga dhimbjet në shpatull. Trajtesa e një rasti të tillë kërkon kujdes dhe inteligjencë, por i fundit që do ta ndërmarrë vendimin final mbi çështjen ‘Botëror’ është vetë 36-vjeçari”.

Jesusi tërheq vëmendjen e Realit

Gabriel Jesus gjatë verës u transferua në Arsenal nga Manchester City dhe forma e lartë e treguar në këtë edicion ka bërë që Real Madridi të shprehë interesim për transferimin e tij. Jesus ishte pranë spanjollëve këtë verë, por nuk mundi ta transferojë për çështje të pasaportës së tij. Trajneri Carlo Ancelotti e admiron brazilianin dhe, sipas “Goal.com”, Jesus është në listën e ngushtë të lojtarëve të përpiluar nga tekniku italian. Sulmuesi brazilian shihet si zëvendësues ideal për francezin Benzema.

Pioli: Lojtarët nuk u bindën skemave që u kërkova

AC Milan pësoi humbje nga Torino në Serinë A me rezultat 2-1. Trajneri i Milanit, Stefano Pioli, pas kësaj humbje, i ka kritikuar futbollistët e tij për humbjen, teksa ka thënë se Torino e meritoi plotësisht fitoren. “Pësuam dy gola shumë shpejt dhe u demoralizuam totalisht. Ne u përpoqëm të reagonim, por nuk ishim mjaftueshëm cinikë. Lojtarët nuk iu bindën skemave që u kërkova. Torino bëri një ndeshje të mirë, na vendosi në vështirësi dhe e meritoi fitoren. Sulmi nuk funksionoi siç unë doja dhe kishim pak thellësi, sidomos në pjesën e dytë”, ka thënë Pioli.

Obama mund të bëhet pronar i ekipit legjendar të NBA-s

Ish-presidenti amerikan Barack Obama është pjesë e një grupi që synon ta blejë skuadrën e Phoenix Suns. Një lajm që ka befasuar të gjithë, publikuar në mediet amerikane dhe që po bën xhiron e botës. Obama është një adhurues i NBA-së dhe shpesh ka bërë parashikimet e tij për skuadra fituese gjatë kohës që ishte në Shtëpinë e Bardhë. Mediet shtojnë se Obama do të jetë personazhi mediatik i këtij grupi biznesmenësh që synon ta blejë skuadrën e njohur të NBA-së. Pronari aktual i Suns, Robert Sarver, që ndodhet në krye prej 18 vjetësh, pritet ta lërë skuadrën dhe është në pritje të ofertave (mes të interesuarve edhe Jeff Bezos). Një nga ikonat e NBA-së dhe Phoenix Suns, Charles Barkley, ka deklaruar: “Kam dëgjuar që Obama është pjesë e një grupi investitorësh që synojnë ta blejnë Suns-in. Nëse Obama do të më marrë në telefon dhe më kërkon t'i bashkohem, do ta pranoj me vrap ofertën”. Barack Obama është një tifoz i Chicago Bullsit.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A - VUSHTRRI
Nr. Protokollit: 1133/22
Data: 28.10.22

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2, dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 01.12.2010, lidhur me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores me nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A., në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A – Vushtri,, e duke u bazuar në vendimin me nr. 1132/22 të datës 25.10.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 28.10.2022 shpall:

KONKURS PUBLIK

(Për plotësimin e vendeve të lira të punës "Sigurim Fizik")

- I. Titulli: Sigurim Fizik
Numri i ekzekutuesve: 2
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi
Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj
I raporton: Udhëheqësit të njësisë së Sigurimit Fizik
Kushtet e veçanta: Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë fizike e preferuar
Koeficienti i pagës: Sipas aktit të brendshëm të Ndërmarrjes.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që e kryen i përgjigjet udhëheqësit të njësisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A. - Vushtri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrat e N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 31.10.2022 deri me datë 14.11.2022 në ora 16:00.

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shitesë mund të kontaktoni në këtë nr.tel. 044 - 732 - 058.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A - VUSHTRRI
Nr. Protokollit: 1133/22
Data: 28.10.22

Na osnovo članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 11 i 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 4 i 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, i člana 11, člana 21. pod st. 2.2 i člana 25 Uredbe 55/21 o radnim odnosima NPL „Përparimi“ Š. A. u Vučitrnu odobreno 21.12.2021, a na osnovu odluke br. 1132/22 od godine 25.10.2022, glavnog izvršnog direktora N.P.L. „Përparimi“ Š. A od 28.10.2022 saopštava:

JAVNI KONKURS

((Za popunjavanje upražnjenog mesta „Fizičko obezbeđenje“))

- I. Naslov: Fizičko osiguranje
Broj izvršilaca: 2
Radno vreme: 40 sati nedeljno
Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od šest (1) godinu, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
Stručna priprema: Srednja škola
Radno iskustvo: Poželjno je šest (6) meseci
Izveštava: Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje
Posebni uslovi: Fizičke sposobnosti, poželjno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbeđenja Favorite
Koeficijent plate: Prema internom aktu Preduzeća.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavestiti nadležna lica;
- Obavezno je koristiti sredstva zaštite na radu;
- Umcti da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, mozetetakode je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za N.P.L. „Përparimi“ Š. A.;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma mora biti ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i mora se doneti u originalu (ne starije od 6 meseci);

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu preuzeti i predati prijavi formular u kancelarijama N.P.L. "Pëparimi" Sh. A u gradu Vuçitru, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vuçitru) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 31.10.2022 do 14.11.2022 u 16:00 časova.

N.P.L. "Pëparimi" Š. A u Vuçitru nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 – 157 – 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, dok će nepotpune prijave biti odbijene.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosovo/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 32 dhe 33 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë, nenit 5 dhe nenit 6 paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 9 Rregullores Nr. 01/2022 për përzgjedhjen dhe përfundimin e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Përfundimit të Prokurorisë, Aktgjykimin nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 dhe Vendimit KPK/Nr.1267/2022 të datës 21 tetor 2022 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpallë këtë:

K O N K U R S

I. DREJTOR I PËRGJITHSHËM I SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

REFERENCA	KPK/SKPK/NJSHP - 01
Emri Pozitës:	Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës
Niveli:	I Lartë Drejtues
Raporton:	Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës
Paga:	Siç përcaktohet nga Këshilli
Numri i Pozitave:	Një (1) pozitë
Kohëzgjatja e kontratës:	Katër (4) vjet
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të administratës dhe Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Udhëheqë dhe përfaqëson Sekretariatit dhe është zyrtari më i lartë administrativ në sistemin prokurorial;
Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Sekretariatit dhe prokurorisë. Drejtori i raporton Këshillit dhe Kryesuesit të Këshillit. Drejtori merr pjesë në të gjitha takimet e Këshillit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informacion; Përfaqëson Sekretariatit në raport me institucionet tjera publike, qeveritare dhe jo-qeveritare; Udhëheq dhe përfaqëson Sekretariatit dhe është zyrtari më i lartë administrativ në sistemin prokurorial;
Zbaton politikat dhe vendimet e Këshillit;
Përfaqëson Sekretariatit në raport me institucionet tjera publike, qeveritare dhe jo-qeveritare; Siguron menaxhimin dhe funksionimin efektiv të Sekretariatit dhe administrimin e prokurorisë;

Planifikon personelin administrativ dhe mbështetës të Sekretariatit dhe prokurorisë;
Bashkërendon aktivitetet në lidhje me përgatitjen e takimeve të Këshillit si dhe hartimin e mendimeve ligjore dhe planeve strategjike;

Mban kontaktet me institucionet e huaja në Kosovë, në kuadër të fushëveprimtarisë së tij;
Udhëheq me strukturën administrative të Sekretariatit dhe administratën e prokurorisë, dhe Nxjerr vendime dhe akte tjera juridike për rregullimin e çështjeve të ndryshme që dalin nga fushëveprimi i tij;

Është përgjegjës ndaj kërkesave të Këshillit për informata dhe raporte nga fushëveprimtaria e tij.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Aftësi të larta organizative dhe Drejtuese duke veçuar ato të planifikimit dhe menaxhimit;
Aftësi për qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve me burime të kufizuara;
Aftësi për përcaktimin e prioritetëve;
Aftësi të larta komunikim dhe negocim e në hartim të akteve e shkresave;
Aftësi për të trajtuar informacion të besueshëm siç duhet;
Aftësi udhëheqëse, motivuese, komunikuese, menaxhim të performancës dhe aftësi për punë ekipore;
Njohuri të duhura për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi Juridik dhe administratës publike;
Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj);
Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare - Fakulteti Juridik, Jurist i Diplomuar dhe të ketë Provimin e Jurisprudencës.

Përvoja e Punës:

Të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë pune nga të cilat së paku katër (4) vite përvojë pune menaxhuese.

II. DREJTOR I NJËSITIT PËR SHQYRTIMIN E PERFORMANCËS SË PROKURORISË

REFERENCA	KPK/SKPK/NJSHP - 02
Emri Pozitës:	Drejtor i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë
Niveli:	I Lartë Drejtues
Raporton:	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës
Paga:	Siç përcaktohet nga Këshilli
Numri i Pozitave:	Një (1) pozitë
Kohëzgjatja e kontratës:	Katër (4) vite
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Njësitit për Shqyrtimin e Përfundimit të Prokurorisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas të Njësitit dhe i raporton drejtpërdrejt Kryesuesit të Këshillit dhe iu përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informata;

Ofron të dhëna statistikore për institucioneve dhe organizatave vendore në aspektin e statistikave dhe analizave;

Siguron zbatimin e vendimeve dhe politikave të Këshillit dhe Kryeprokurorit të Shtetit brenda fushëveprimtarisë së NJSHP-së;

Është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm dhe për zbatimin e ligjshmërisë së punës brenda NJSHP-së;

Harton dhe zbaton planifikimin e punës së NJSHP-së në pajtim me politikat, strategjitë dhe planet e punës së Këshillit dhe Kryeprokurorit të Shtetit;

Mbikëqyrë procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore të punës së prokurorisë, hartimin e raporteve dhe rekomandimeve;

Bashkërendon aktivitetet dhe bashkëpunon me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit dhe njësitë e tjera brenda sistemit prokurorial dhe institucioneve të tjera në kuadër të fushëveprimtarisë së NJSHP-së;

Përgatitë raporte të rregullta periodike dhe sipas kërkesës së Këshillit, Prokurorit të Shtetit për punën e NJSHP-së;

Kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të sistemit prokurorial.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Aftësi të larta organizative dhe Drejtuese duke veçuar ato të planifikimit dhe menaxhimit;

Aftësi për qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve me burime të kufizuara;

Aftësi për përcaktimin e prioritetëve;

Aftësi të larta komunikim dhe negocim e në hartim të akteve e shkresave;

Aftësi për të trajtuar informacion të besueshëm siç duhet;

Aftësi udhëheqëse, motivuese, komunikuese, menaxhim të performancës dhe aftësi për punë ekipore;

Njohuri të duhura për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi Juridik dhe administratës publike;

Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj);

Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare - Fakulteti Juridik, Jurist i Diplomuar dhe të ketë Provimin e Jurisprudencës.

Përvoja e Punës:

Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune nga të cilat së paku tri (3) vite përvojë pune menaxhuese.

Kushtet e përgjithshme:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët;
3. Të mos jenë të dënuar për veprë penale;
4. Të mos të kenë aktakuzë të ngritura ndaj tyre;
5. Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal dhe të mos kenë pasur masë të rëndë disiplinore të shqiptuar në pesë (5) vitet e fundit;
6. Të ketë diplome universitare, të jetë jurist i diplomuar dhe të ketë provimin e jurisprudencës
7. Të ketë përvojë pune relevante prej shtatë (7) vite për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, prej të cilave katër (4) vite përvojë menaxhuese, ndërsa për Drejtor të NJSHP-së të ketë përvojë pune prej pesë (5) vjetësh, prej të cilave tre (3) vite përvojë menaxhuese.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data **01.11.2022 deri me datë 15.11.2022** si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- **Aplikimi në mënyrë elektronike:** Pas plotësimit, aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet e skanuara të cilat kërkohen sipas konkursit në formatin PDF, dokumentacioni dërgohet në postën elektronike: burimet.njerzore@rks-psl.org, ku me pas ju do të pranoni konfirmimin për dërgesën e aplikacionit tuaj në mënyrë elektronike.
- **Aplikimi përmes postës:** Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- **Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**
 - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
 - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
 - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- **Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:**
 - Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, të bashkangjitur në aplikacion, të nostrifikuara (për diplomat e marra jashtë vendi);
 - Kopjet e dëshmisë së përvojës së punës;
 - Referencat e ndryshme të punësimeve të mëparshme;
 - Certifikatën që nuk është në hetim dhe
 - Letër motivuese.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Tužilački Savet Kosova na osnovu člana 32 i 33 Zakona Br.06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, Zakona Br. 03/L/-149 o Civilnoj Sluzbi Republike Kosova, člana 5 i 6 stav 3, 4, 5, 6 i 9 Pravilnik Br. 01/2022 o izboru i završavanju mandata Generalnog Direktora Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova i Direktora Jedinice za Razmatranje Performanse Tužilaštva, Rešenja sa br. Ref AGJ.1583/20 datuma 09 jula 2020 i Odluke TSK/Br.1267/2022 datuma 21 oktobar 2022 Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje sledeće:

KONKURS

I. GENERALNI DIREKTOR SEKRETARIJATA TUŽILAČKOG SAVETA KOSOVA

REFERENCA	KPK/SKPK/NJSHPP - 01
Naziv Pozicije:	Generalni Direktor Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova
Nivo:	Visoko Rukovodeći
Izveštava:	Predsedavajući Tužilačkog Saveta Kosova
Plata:	Kao što je Savet odredio
Broj Pozicija:	Jedna (1) pozicija
Trajanje ugovora:	Četiri (4) godine
Mesto:	Priština

Cilj radnog mesta:

Odgovoran je prema Savetu o efikasnom i efektivnom upravljanju administracije i Saveta i Državnog Tužioca.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Rukovodi i zastuplja Sekretarijat i najviši je administrativni službenik u tužilačkom sistemu; Direktor je odgovoran prema Savetu za efikasno i efektivno upravljanje Sekretarijata i tužilaštava. Direktor neposredno izveštava Predsedavajućem Saveta. Direktor ucesvuje u svim sednicama Saveta i odgovara na sve zahteve Saveta za informacijama; Rukovodi i Zastuplja Sekretarijat i najviši je administrativni službenik u tužilačkom sistemu; Sprovodi politike i odluke Saveta; Zastuplja Sekretarijat u odnosu na druge javne, vladine i nevladine institucije; Obezbeđuje efektivno upravljanje i funkcionisanje Sekretarijata i upravljanje tužilaštvima, Planira administrativno i pomoćno osoblje Sekretarijata i tužilaštva; Koordinira aktivnosti vezane za pripremu sednica Saveta kao i izradu pravnih mišljenja i strateških planova; Održava kontakte sa stranim institucijama na Kosovu, u okviru svog delokruga; Rukovodi administrativnom strukturom Sekretarijata i administracijom tužilaštava, i Izdaje odluke i druge pravne akte za regulisanje različitih pitanja koje proizlaze iz njegovog delokruga; Odgovoran je prema zahtevima Saveta za informacije i izveštaje iz njegovog delokruga;

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Visoke organizacione i upravljačke sposobnosti, posebno one o planiranju i upravljanju; Sposobnost za pragmatični pristup u pronalaženju rešenja sa ograničenim resursima; Sposobnost određivanja prioriteta;; Visoke komunikacijske i pregovaračke sposobnosti u izradi akata i dokumenata; Sposobnost pravilnog tretiranja pouzdanih informacija; Rukovodilačke, motivacijske, komunikativne veštine, upravljanje performanse i sposobnost za timski rad; Adekvatna znanja za efektivan nadzor stručnog rada obavljenog od strane podređenih; Odlično i sveobuhvatno stručno znanje iz oblasti prava i javne uprave; Dobro poznavanje i veštine rada sa računarom pomoću programa (Microsoft Word, Excel, Power Point, itd). Poznavanje jenog od službenih jezika u skladu sa zakonom o jezicima

Profesionalna priprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma – Pravni Fakultet, Diplomirani Pravnik i da ima Pravodusni Ispit.

Radno iskustvo:

Da ima najmanje sedam (7) godina radnog iskustva od kojih najmanje četiri (4) godine radnog iskustva u rukovođenju.

II. DIREKTOR JEDINICE ZA RAZMATRANJE PERFORMANSE TUŽILAŠTVA

REFERENCA	KPK/SKPK/NJSHPP - 02
Naziv Pozicije:	Direktor Jedinice za Razmatranje Performanse Tužilaštva
Nivo:	Visoki Rukovodeći
Izveštava:	Predsedavajući Tužilačkog Saveta Kosova
Plata:	Kao što je Savet odredio
Broj pozicija:	Jedna (1) pozicija
Trajanje ugovora:	Četiri (4) godine
Mesto:	Priština

Cilj radnog mesta:

Direktor je odgovoran prema savetu o efikasnom i efektivnom upravljanju Jedinice za Razmatranje Performanse Tužilaštva.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Odgovoran je prema Savetu za efikasno upravljanje Jedinice i direktno odgovara Predsedavajućem Saveta i odgovara na sve zahteve Saveta za informacijama. Pruža statističke podatke za lokalne institucije i organizacije u smislu statistike i analize; Obezbeđuje sprovođenje odluka i politika Saveta i Glavnog Državnog Tužioca iz delokruga JRPT-a. Odgovoran je za opšte rukovođenje i upravljanje i za sprovođenje zakonitosti rada u okviru JRPT-a. Izradi i sprovodi planiranje rada JRPT-a u skladu sa politikama, strategijama i planovima rada Saveta i Glavnog Državnog Tužioca; Nadgleda proces prikupljanja i obrade statističkih podataka o radu tužilaštava, izradu izveštaja i preporuka; Koordinira aktivnosti i saraduje sa Generalnim Direktorom Sekretarijata i drugim jedinicama u unutar tužilačkog sistema i ostalim institucijama u okviru delokruga JRPT-a. Priprema redovne periodične izveštaje, a prema zahtevu Saveta, Državnog Tužioca o radu JRPT-a. Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonom i podzakonskim aktima tužilačkog sistema.

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Visoke organizacione i upravljačke sposobnosti, posebno one o planiranju i upravljanju; Sposobnost za pragmatični pristup u pronalaženju rešenja sa ograničenim resursima; Sposobnost određivanja prioriteta; Visoke komunikacijske i pregovaračke sposobnosti u izradi akata i dokumenata; Sposobnost pravilnog tretiranja pouzdanih informacija; Rukovodilačke, motivacijske, komunikativne veštine, upravljanje performanse i sposobnost za timski rad; Adekvatna znanja za efektivan nadzor stručnog rada obavljenog od strane podređenih; Odlično i sveobuhvatno stručno znanje iz oblasti prava i javne uprave; Dobro poznavanje i veštine rada sa računarom pomoću programa (Microsoft Word, Excel, Power Point, itd). Poznavanje jenog od službenih jezika u skladu sa zakonom o jezicima.

Profesionalna priprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma – Pravni Fakultet, Diplomirani Pravnik i da ima Pravodusni Ispit.

Radno iskustvo:

Da ima najmanje pet (5) godina radnog iskustva od kojih najmanje tri (3) godine radnog iskustva u rukovođenju.

Opšti uslovi:

1. Da bude državljanin Republike Kosova;
2. Poznavanje jednog službenog jezika u skladu sa zakonom o jezicima;
3. Da ne bude kažnjen za krivično delo;
4. Da nema podignute optužnice protiv njih;
5. Da ima visoku profesionalnu reputaciju i lični integritet i da nemaju disciplinsku meru izričenu u poslednjih pet (5) godina;
6. Da ima univerzitetsku diplomu, da bude diplomirani pravnik i da ima položen pravodusni ispit.
7. Da ima odgovarajuće radno iskustvo od sedam (7) godina za poziciju Generalnog Direktora STSK-a, od kojih četiri (4) godine iskustva u rukovođenju, dok za Direktora JRPT-a da ima radno iskustvo od pet (5) godina, od kojih tri (3) godine iskustva u rukovođenju.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u službenoj stranici Tužilačkog Sistema Republike Kosova, kao i u dnevnim novinama, počevši od **01.11.2022 do 15.11.2022** kao datum kada se konkurs završava.
- Zahtev (aplikacija) za zapošljavanje nalazi se na veb stranici: www.prokuroria-rks.org
- Aplificiranje elektronskom formom: Nakon popunjavanja, aplikaciji priložite skenirane dokumente koje se traže konkursom u formatu PDF, dokumentacija žalje se elektronskom poštom: burimet.njerëzore@rks-psl.org, gde ćete zatim dobiti konfirmaciju za dostavljanje vaše aplikacije elektronskim putem.
- Aplificiranje putem pošte: Kompletirane zahteve sa dokumentacijom možete dostaviti i putem pošte u Diviziji za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Ulica "Luan Haradinaj", br. 100, Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije dostavljene putem pošte koje sadrže pečat pošte o dostavljanju poslednjeg dana roka za apliciranje, smatarće se važećim i uzimaće se na razmatranje, ako stignu u roku od 4 dana, aplikacije koje stignu nakon ovog roka i one nekompletirane neće biti uopšte razmatrane.
- Po potrebi možete nas kontaktirati na tel: 038/200 18874 od 08:00 – 16:00.
- Uslovi učesća na konkursu:
 - Pravo na apliciranje imaju svi punoletni građani Republike Kosova koji imaju potpunu sposobnost delovanja, koji su u potpunim građanskim i političkim pravima, imaju potrebnu obrazovnu pripremu i profesionalnu sposobnost za vršenje dužnosti i koji imaju fizičke sposobnosti koje se traže za odgovarajuću poziciju.
 - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža ravnopravne mogućnosti za sve državljane Kosova i očekuje aplikacije od svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu.
 - "Ne većinska zajednica i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe javne centralne i lokane uprave kao što je specifikovano članom 11 stav 3 Zakona Br.03/L-149 o Civilnoj Sluzbi Republike Kosova."
- Aplikaciji treba se priložiti skenirane kopije tražene dokumentacije:
 - Kopije diploma izdate od strane obrazovnih institucija, priloženo uz aplikaciju, nostrifikovane (za diplome koje su stečene van zemlje);
 - Kopije dokaza o radnom iskustvu;
 - Razne referense predhodnih zapošljavanja;
 - Sertifikat da nije pod istragom i
 - Pismo motivacije.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove predviđene na osnovu ovog konkursa, kandidati biće upozantni na osnovu pravosnažnog zakona.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte


RESTAURANT


SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553
PRISHTINË



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Hysni Kamberaj B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NUI: 810354225.

- Imer Hajdini shpall te pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me NRB: 600010384.

- Ali Sadiku shpall te pavlefshme dëftesat e klasës 10/11 e SHMLT "Arkitekt Sinani".

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na

kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
Since 1903
0.5L